

ITALIA, ITALIANËT DHE ITALIANITETI NË LETËRSINË SHQIPTARE TË PERIUdhËS SË KOMUNIZMIT

ITALY, ITALIANS AND ITALIANITY IN ALBANIAN LITERATURE OF COMMUNIST PERIOD

ANESTI NAÇI

Dipartimento di Storia e Tutela dei Beni Culturali, Università degli Studi di Udine
Udine, ITALIA

Email: anestinaci@hotmail.com

AKTET VI, 4: 360 - 365, 2013

PËRMBLEDHJE

Michel de Certeau thoshte «letërsia i rri historisë si matematika shkencave ekzakte» dhe pra pikërisht *Italia në letërsinë shqiptare të periudhës së komunizmit* konsiderohet një fenomen social i mirëfilltë në një *divenire* historik domethënës, që meriton një analizë vërtetësisht historike ndërdisiplinore. Prezenca historike e Italisë dhe italianëve, pra *italianitetit*, në letërsinë shqiptare është bivlerësuese ose dyzyese: do të thotë analizë mbi historinë e përbashkët italo-shqiptare, kthyer në letërsi (e kaluara dhe memorja e saj) dhe fenomeni psiko-social që vetë letërsia prodhon. Pra, idetë, perceptimet dhe imazhet – të arsyeshme apo të nënndërgjegjshme qofshin – që hyjnë në jetë, ndërveprojnë me të përditshmen apo me të përbrendshmen njerëzore, duke ndikuar në ëndrrat dhe vizionet e popullit dhe krijojnë kështu një fenomen historik të dyfishtë.

Fjalët çelës: imazh, italianitet, letërsia shqiptare, kulturë, realizmi socialist.

SUMMARY

This interdisciplinary study is a historical analysis of the cultural importance of Italy's image in Albanian literature of the second half of the twentieth century and its psycho-social consequences. The presence of Italy in Albanian literature of the communist period is a social phenomenon which developed through time. Italy's image is very vivid in the writings of intellectuals of the communist period, but there is not a scientific analysis of its presence. The analysis of Italy, Italians and Italianity in Albanian literature is ambivalent, on one hand, it is an analysis of the commune Italo-Albanian history expressed and transformed in literature, and on the other hand, it is a historical phenomenon that is produced by literature itself. Thus, ideas, perceptions and images, rational or subconscious, become part of our lives and intervene in everyday's life, influencing visions of people and thus creating a double historical phenomenon.

Key words: Image, Italianity, Albanian literature, Culture, Social realism.

HYRJE

Shkruhet Italia në letërsinë shqiptare të realizmit socialist, por realisht është Italia e memorjes, e bashkëjetesës, prezantuar mbas verdiktsh historikë, nga një pikëpamje e re dhe nën të tjera thirrje ideologjike. Por dhe duke konsideruar rolin pedagogjik e propagandues që shteti monist ka dashur t'i atribuojë letërsisë, gjithësesi

përthellimi mes të pandërgjegjshmes, romantikes dhe realizmit, fundamental për një vepër arti, ekziston dhe është evident pothuajse në gjithë krijimtarinë e autorëve më të ndritur. Secili prej tyre, sipas ndjenjave, eksperiencës, apo imagjinatës përshkruan Italinë e vet: të ëndërruar në rini; të urryer e të luftuar kur është e veshur me të zeza; për ta mëshiruar e shpëtuar me ushtarët e saj

të shpartalluar, dhe përsëri “të afërt” si armike e ftohtë me *ushtrinë* e saj tashmë të *vdekur*.

Petro Marko dhe Italitë e përjetuara

Italia në dimensione artistikisht pluraliste vjen fillimisht me Petro Markon, Italia e të cilit e dashur dhe e adhuruar, është individuale, thellësisht e ndjerë personale dhe pikërisht për këtë dhe më e besueshme. Bën deri diku përjashtim Italia e *Ultimatum*-it, ajo pra e 1920^{ës}, që dhe pse i ndërtuar mjeshtërisht, paraqet të romanëzuar portretet dhe stereotipet mbi italianët marrë prej historiografisë, mitit gojor të luftës dhe këngës popullore. Tek *Ultimatum* Marko përmbledh dhe tregon *ex-novo*, shumë prej gjykim-paragjyqimeve mbi italianët në filluesën e tyre, i ndihmuar prej një njohje kapilare të kulturës, jetës dhe historisë së vendit të Dantes. Italia e çeliktë, me teknologji e ushqime; *pipinot* me femra të bukura e qeflinj të një *Dolce vita* ante literam dhe njerëz të mirë e humanë, por dhe pushtues, kolonizues, breshkaxhinj e lla-fazanë, qaramanë e djem mamaje, ku thirrja «mamma mia!» vazhdon të mbetet metër-vlerësimi i burrërisë së tyre. Gjithsesi, si këtu por sidomos në romanet e tjera, Petro Marko nuk rrëshket kurrë në stereotipizime banale të Italianit. Ndryshe nga imazhi që kërkon të pjellë e shpërndajë realizmi socialist zyrtar me direktivat e tij ideologjike, italianët e tij mund të jenë katilë ose jo, trima ose frikacakë, por nuk portretizohen kurrë si tejet të femëruar e qesharakë, dhe pse qëndrimet të tyre të pa dinjitet – sepse mbi të gjitha pushtues – i kundërvihet burrëria karakteriale e mashkullit tradicional shqiptar i mbërthyer në kodin e nderit, sikundër i thotë labi fshatar në burg karabinierit: «ju nuk jeni burra, ja më vrisni ja më lini. A rrihet burri i lidhur? Breshkaxhinj!» (Marko, *Ultimatum*: 130).

Petro ka një dobësi të vecantë për këtë popull «punëtor, shembull pune dhe krijimi» (Marko 2000: 140). Dimensioi njerëzor i Italianit, ai idealist i një populli që mbart në shpirt madhësinë e së kaluarës vjen prej Markos nëpërmjet personazheve ku dominojnë njerëzit e thjeshtë e të mirë, si pasqyrë e një populli të

ngjashëm. Insistimi në ngjashmërinë humano-kulturore me italianët, mund të interpretohet si rrjedhojë e një dëshire, por është kryesisht pohimi i dinjitetit evropian që na përket përkrah këtij vendi-djep i kulturës evropiane. Vëllazëria italo-shqiptare konfirmohet në idealet internacionaliste të Luftës së Spanjës dhe faqet e *Hasta la vista*-s që Petro i dedikon. Por duke miranalizuar *Hasta la vista*-n të del menjëherë përpara syve universi i tij kozmopolit, ku dominon elementi Itali dhe italianiteti. Ekziston nëpër faqet e romaneve të Markos një botë që nuk është vetëm Shqipëria, por, sigursht i kushtëzuar prej periudhës historike, ajo është Italia dhe Shqipëria së bashku; është një botë kufitare si terren jete. Vitet e jetës së tij janë dhe terreni historik i veprës letrare. Njohja mbi këtë vend, krijon një Itali të diversifikuar. Janë disa Italira të përfaqësuar në jetën e tyre. Italia si vendi i Kulturës, si një popull bujar dhe i ngjashëm, punëtor dhe i thjeshtë; por dhe vend i zhvilluar e prurës i modernitetit. Mbi të gjitha Italia e Markos është vend i së Bukurës dhe i Dashurisë sjellë mes teatrove dhe skenave, ballove dhe këngëve të dashurisë. «Ku duron dot Roma pa dashuri» lexohet në faqet e *Natës së Ustikës*, (Marko 2010: 132). Dashuri italiane, totale dhe gjithëlojshme, që pushton dhe komunist Lekën për prostitutën bukurisht tejet italiane Ana Maria Monti tek *Qyteti i fundit*. Si Beylist i vërtetë, dhe pse pa pasur në trashëgimni supremacinë gjyquese të Francës si Stendhali, Marko në veprën e tij përshkruan Italinë në një mënyrë magjistrale, mes kontrasteve dhe realitetit shumëdimensionësh tipik të *Bel Paese*-s, në ngjyrat e bukurisë dhe madhësisë së Artit dhe Dashurisë së pashtershme. Italia vjen nëpërmjet romaneve të Markos më reale dhe e plotë se te kushdo. Përcillet tek kultura jonë Italia në të gjitha format e saj, sa që mund të shihet si një shëtitje feliniane nëpër të ndërmjet *Amarcord*-it dhe *La dolce vita*-s, dhe pse në sfond gjithnjë realiteti i Luftës dhe kushtëzimi i retorikës së ideologjisë ekzigjente. Retorikë që Marko ka ditur ta hollojë mirë përmes së vërtetës së ndier, reales së jetuar dhe kozmopolitizmit evropian kundër internacionalizmit të imponuar, realizmit

socialist artificial apo historicizmit udhërfyese, duke prurë në letërsinë tonë më prekshëm se kurrë Italianitetin bashkëkohor dhe historik, derisa arrin të paraqesë mrekullisht një univers të tërë Italian, jetën e *piazza*-ve italiane, në sheshin e vogël portual të *Qyteti të fundit*.

Romani i Petros i vlerësuar dhe ndoshta nëndërgjegjësish i adhuroar prej kritikës së regjimit, – pikërisht sepse i mëshon lehtë miteve përgjithësuese si atij të Luftës Nacional-çlirimtare, mikëpritjes dhe trimërisë shqiptare, apo retorikës ndarëse moralisht mes “ne dhe ata” – gjithsesi kritikohet: «krahas anës tragjike, të ishte nënvizuar më tepër ana heroike e luftës tonë çlirimtare, sidomos kundër pushtonjësve italianë. Në këtë mënyrë edhe e vërteta historike do të ishte dhënë më e plotë...» shkruan Razi Brahimi (Brahimi 1965: 192). Obsessionit të historicizmit Petro Marko i përgjigjet më së miri në përshkrimin e Italisë, italianëve dhe raportit të midisshëm aq sa kufiri nga romani tek historia është vështirë të piketohet. Shpesh historikja kthehet në politike, por tek Marko ky razionalizim i lë vendin ndjesisë, subjektivës psiko-shpirtërore, tregimit të virgjër udhëtues mes italianëve, Italisë dhe brendësisë njerëzore të tyre.

Italia e Luftës në pena të tjera të realizmit socialist

Dimensioni historik, bashkë me mitet e ndërhuara mbi të është prezent, dhe s’mund të ndodhte ndryshe, tek e gjithë letërsia e realizmit socialist lidhur me Italinë, ku tematika e Luftës Nacionalçlirimtare dhe miti i saj tejet i ekzaltuar me fitoret historike kundër fashistëve: frikakakë, djem mamaje, breshkaxhinj edhe pipino, por dhe kriminelë, të këqij, gënjeshtarë e llafazanë, është gjithëpërfshirës. Letërsia minore, ajo lehëse e regjimit, njihet degradime dhe një fosilizim të ngjarjeve përsëritshmërisht të njëjta dhe të personazheve – sidomos ato të italianit – që dhe vetë kritika zyrtare do t’ua vërë në dukje. Fatmir Gjata, ish partizan e shkrimtar ndër themeluesit e gjinisë thekson si «përshkrimi në romanet e Luftës bëhet me zbehtësi, skematizëm... përsëritje situatash e karakteresh /.../ personazhe që shëtisin nga njëri libër tek tjetri /.../ armiku jepet

i dobët dhe frikakak, si prej letre, si butafori» (Gjata 1984: 229-230). Prezantimi i italianit, si pushtues fashist, por njëkohësisht dhe si frikakak, për bersalierët: «thonë se kanë pendë maje kokës, si të këndesave. – Ligsht, që t’i vrasim në vend të pulave» lexohet tek *Përmbysja* e vetë Gjatës qysh prej 1954, ose më tej, si ushtarët italianë «laheshin lakuriq duke kënduar “o campagnola bella” dhe prisnin gratë e vajzat e fshatit për t’i ngacmuar» (Gjata 1954: 114). Udhëshkelës i stereotipeve prozaike mbi italianët Gjata flet për *pipinot* dhe si të bukur e të veshur mirë, «me flokët të lyera si me vaj /.../ llafazanë», qaramane alla *mamma mia*, ndonjëherë dhe naivë e deri budallenj me të cilët mund të tallej ç’do fshatar shqiptar. Gjithsesi qëndron i kristalizuar gjykimi masiv për italianët si «njerëz të mirë, hallexhinj e punëtorë», por që s’janë për luftë dhe shpesh keqësia e tyre, për nevojshmëri ideologjike, u vendosej oficerave, që jepen gjithnjë me prejardhje shtresash të larta italiane (Gjata 1954: 149-152).

Prej kësaj ndryshon disi Italia prezatuar në veprën e Shuteriqit qysh më 1952 me *Çlirimtarët*. Italia prezantohet gjithësesi shumëformëshe, dhe pse vetëm ironikisht e fuqishme apo e zhvilluar, dhe e shoqëruar prej retorikës së fitores, ku megjithatë sproporcionin në forza, 40 milionë kundër 1, shqiptarët arrijnë të fitojnë. Emrat personalë, qytetet, ushtria por dhe këngët apo kultura italiane janë gjithnjë prezente dhe të mirënjohura, dhe pse ndoshta pa elementin psikologjik e shpirtëror që arrin të dhurojë Petro Marko, gjithsesi krijohet një ndjesi ngjashmërie mes këtij populli fqinj human për shumë aspekte të jetës, por morali dhe trimëria qëndrojnë gjithnjë nga ana jonë, sepse Italia është «ajo e pa besa e të pa besave» dhe pse vënë në gojën e një hoxhe fshati (Shuteriqi 1952: 232). Prezantimi i Italisë shkon deri duke dhënë kontrastin italian shekullor Veri-Jug: «napolitan palaço», thotë major Biondini torinez, «italianët e jugut i kanë nxjerrë namin kombit tonë se gjoja është llafazan» (Shuteriqi 1952: 192). Të ngjashme mund të konsiderohen Italitë dhe italianët e Abdihoxhës apo Shevqet Musarajt.

Një Itali e prurë originalisht është ajo e Dritëro Agollit te romani *Njeriu me top*, i ndërtuar mbi temën dhe mitin e shpëtimit dhe mbajtjes së ushtarëve italianë nëpër shtëpitë e fshatarëve mbas 8 shtatorit tragjik të asaj «ushtri mavrie» siç e quan Mato Gruda (Agolli 2000: 84). Këtu ndërthurra dhe afërsi-diversiteti mes popujve dhe kulturave jepet mrekullueshëm ndërmjet një humori popullor unik. Ushqimi ose mishi i fukarait, “fasulja” tek ne dhe “makarunet” tek italianët, tregojnë ndryshime dhe njëkohësisht afrojnë kulturat dhe popujt. Augusto, italiani i Agollit qan, por jo si i keq apo thjesht frikacak, por si i mirë e i urtë, i vogël përballë tmerrit gjigant të një lufte të pashpjegueshme, por gjithsesi Mato Gruda dhe pse «nuk i pëlqente burrat që qajnë, nuk e përbuzi italianin» që shpesh ngashëronte i mbledhur ne vetvete, «por e vështronte me keqardhje» (Agolli 2000: 97).

Autori bën të kuptohet se si fjala “italiani”, gjatë gjithë periudhës në të cilën është ambjentuar romani, ishte plasuar me figurën e atij që bridhte nëpër Shqipëri duke kërkuar strehë, mëshirë dhe paqe, ku bujaria e shqiptarit, dhe pse shpesh arrogant, ignorant e dyshues duke e nëpërkëmbur, nuk i mungoi. «Italiani i ngordhur ë...ç do të marr një hu e do ta zhdëp mirë – i thotë Zara Mato Grudës, dhe vazhdon – pastaj ti vetë më ke thënë që ata janë pushta» (Agolli 2000: 70). Paburrëria, aq sa mund t’i rrahin dhe gratë dhe feminizmi jepen si “karakteristikat” kryesore të tyre. Por për Maton ata janë punëtorë, biles «ta kemi si shërbëtor – thotë – se italianëve, ç’u sheh syri u bën dora» (Agolli 2000: 73). Por, bashkë me konsideratën dhe humanizmin që u vihat në dukje, shpesh notat e poshtërimin dhe ofendimit kundër tyre, që rrjedhin prej situatës në të cilën ndodheshin, janë të shumta, duke filluar që prej emrit: Mato qysh në fillim i thërret Agush, e jo në emrin e vet Augusto. Armiqësi-miqësia jepet nëpërmjet një dialogu interesant, kur Augusto thotë se po të vinte dhe Mato në Itali, edhe ai kështu do t’a kishte pritur e shpëtuar. «Ti nuk do të më prisje kështu, se unë nuk do të vija me pushkë si ti» i përgjigjet Mato Gruda (Agolli 2000: 98).

Në këtë roman jepet në mënyrë magjistrale diferenca fatkeqësisht e vërtetë në shkollim dhe kulturë mes italianit dhe fshatarit shqiptar. Nga njëra anë ekzagjerimi i Matos fryt i mbylljes së tij – «që thua ti, as ky Dantja s’i ka parë në ëndërr ato historira që di unë» dhe nga tjetra konstatimi i së vërtetës së hidhur kur sheh ditarin e Augustos: «Evropa shkruan, ne mezi dimë të bëjmë dy kërraba» (Agolli 2000: 189). Dhe ja pra, italianët nëpër fshatrat e Shqipërisë të humbur e të harruar, vuajtës fatesh më të mëdhenj se ta, qofshin gjithsesi të ligj, apo frikacakë, qefllinj fe-mrash apo njerëz të mirë, ngelen përfaqësues të një kulture që është për Mato Grudën, dhe në përgjithësi për shqiptarët “Evropë”. Tek *Njeriu me top* afrimiteti mes njeriut italian dhe shqiptar, ngjashmëria e pamendueshme mes kulturave sillet prej autorit me një gjetje gjeniale e paradoksale, nëpërmjet diversitetit dhe kontrasteve në figurat kryesore të Matos dhe Augustos.

Kadareja dhe vizionet e tij italiane

Shumë më e nëndheshme dhe komplekse për t’u analizuar është Italia dhe italianiteti i Kadaresë. Të gjithë romancierët e lartpërmendur e kanë trajtuar mes adhurimit, konsideratës, përçmimit e paragjykimeve, dhe gjithsesi duke kërkuar një vend dinjitoz për Shqipërinë dhe kulturën tonë në raport me Italinë. Kadareja, moskokëçarës ndaj asaj *politically correct* që dhe ajo kohë kishte në format e saj, ka bërë të njëjtën gjë, por ndoshta me një dozë më të lartë intranzigjence dhe “fodullëku letrar”. Tematika e trajtuar është e njëjtë pothuajse: tek *Kronikë në gur* Lufta, me Italinë fillimisht të fortë, pastaj e thyeshme me grekët, e akoma më e dobët me ne, deri sa konfirmohet ajo “gruaja llafazane” kadareane, që lë nëpër shkëmbinjtë e Shqipërisë *ushtrinë e saj të vdekur* për ta rimarrë eshtra e arkivole nëpërmjet një *Gjenerali*, mes nostalgjisë së tij për luftën dhe nënvleftësimin etnik, e përkrah botës shpirtërore të një Prifti katolik. Imazhi që duhej të kishte shqiptari i kohës mbi Italinë jepet si dritare mbi Luftën nëpërmjet ditarit të atij «qaramani sentimental» tek *Gjenerali* (Kadare 2007: 126) dhe sigurisht nëpërmjet *Kronikës së gurtë*, dhe

konfrontohet natyrshëm me imazhin dhe gjykimet reciproke në të tashmen mëvonshme të Luftës së Ftohtë, ku gjenerali, pra pushtimi dhe prifti pra, feja, binomi më frikëfutës për Shtetin e atëhershëm dhe shqiptarët, jepet prej Kadaresë në një mënyrë magjistrale. Italiani i Kadaresë i dyzuar mes fesë dhe erotizmit, paraqitet në mënyrë origjinale mes prezencës së pandarshme të murgeshave dhe prostitutave; ai s'jeton dot, jo pa dashuri si tek Petro Marko, por pa femrën si objekt erotik. Dashuria italiane kalon në një erotizëm ditor, imazh të cilit i vihet në krahë dhe femëzimi i mashkullit ushtar. Nuk mund të ishte veçse italian ai «oficer i kapur për veshi nga plaka Shano, deri sa e rrëzoi përdhe duke e goditur me duart e saj tërë kocka» dhe natyrisht, jo për ç'është Lufta, por «sepse i vinte rrotull mbesës së saj»; hallë Xhemoja thotë «s'guxon të dalë vajzë e nuse në dritare» dhe se ndër «kaq ushtrira që kam parë, ushtarë që të hidhnin livando s'besoja se do shikoja kurrë» (Kadare 2007: 79; 137).

Kontrasti më i fortë me Italianin dhe botën e tij, përveç raportimit me femrën, është “fjala”. Italiani i Kadaresë është llafazan, në këtë aspekt antitezë ekzistenciale e shqiptarit dhe botës së tij. Ushitari i ditarit tek *Gjenerali* e përforcon këtë imazh duke e dhënë të vlerësuar nga pikëpamja italiane argumentin: «Mullisi është njeri i mirë, por ka një huq, flet rrallë. Kam vënë re që shqiptarët në përgjithësi flasin pak, sidomos burrat» (Kadare 2007: 112). Dhe ja pra, gratë flasin, dhe mund të flasin si karakteristikë e tyre me fjalë ere, por mashkulli jo, dhe Italiani që flet, del si grua, si grua e ligë do të thuhej. Dhe Kadareja, si kritik më parë se si shkrimtar, konsideron metafizikisht Italianin tek *Autobiografi e popullit në vargje* si «grua llafazane» dhe pse si interpretim i vizionit të popullit (Kadare 1981: 53). Konsiderata e Italianit të asaj periudhe, bie akoma më poshte tek Kadareja, kur të pajtuarit të fshatari, s'i thirret fare në emër, ndryshe prej Agushit të Dritëroit, biles – shkruan Italiani, në ditar – «të gjithë më thërrasin ushtar. Asnjëri s'më ka pyetur për emrin e vërtetë» (Kadare 2007: 108).

Zhvlerësimi për njëfarë Italie, asaj që vetëkonsiderohet, mendjemadhe dhe na nëvleftëson – për këtë vend më tepër i ngjashëm se i largët – vjen nëpërmjet Kadaresë si monedhë shkëmbyese dhe me një dozë të lehtë cinizmi intelektual, për t'i dhënë kulturës dhe popullit tonë dinjitetin dhe vendin që i përket. Dhe Kadareja nuk e bën këtë prej shtytjes dhe orientimit të ideologjisë nacional-komuniste, por prej ndjesisë ekstreme dhe thellësisë së mendimit të një intelektualit me dimensione evropiane. Ndofta jo e vetmja, ndofta jo më e mira, por kjo zgjidhje, duke konsideruar udhën e pashmangshme drejt vlerësimit universal të fenomenit Kadare, rezultoi më adaptja për t'ia arritur qëllimit. Dhe jo më kot bota e kritikës letrare italiane, ku përfshihet e gjithë ajo e majta intelektuale, me përjashtime të vogla, por dhe establishmenti politik italian i atëhershëm në fuqi, nga Demokracia Kristiane tek Socialistët, shohin Kadarenë si intelektualin shqiptar më cinik dhe, në mos anti-italian, si jo filo-italian. Imazhi apo imazhet e Italisë dhe italianëve, në veprën e Kadaresë janë të tilla jo prej anti-italianitetit, por prej lirisë shprehëse dhe imagjinare të shkrimtarit të *Pallatit të ëndrrave*. Kadareja i ka kuptur dhe si profet parashikuar më mirë se kushdo paragjykimet e italianëve mbi ne dhe e ka vënë në dukje këtë anë të “Italisë së mirë”, sepse «dhe vdekja jonë është më e bukur se jeta e tyre» thotë Gjenerali; «shqiptarët gjithnjë kanë pasur dëshirë të vrasin ose të vriten, ata janë vrarë me njëri tjetrin kur nuk kanë pasur me kë të luftonin; /.../ shqiptarët janë një popull i ashpër dhe i prapambetur» thotë prifti (Kadare 2007: 144, 44). Dhe Kadareja kthehet në profet kur në gojën e gjeneralit vë thënien ndoshta më të vërtetuar prej bashkohësisë historike: «Ç'popull! – po me sa duket, popuj të tillë më lehtë se dhuna, ndoshta mund t'i mposhtë gjëja e bukur» (Kadare 200: 54).

Konkluzione

Italia në Letërsinë shqiptare të realizmit socialist paraqitet e tillë, ku sensi historik e dokumentar, i kërkuar prej regjimit, do të ndërthurret me artistiken, memorjen dhe krijimtarinë, duke dhuruar si riiinterpretime të historisë, ashtu dhe

mite dhe stereotipe, gjykime dhe paragjykime që do të ngelen e formojnë bestytinira etniko-sociale të palëvizshme karshi botës italiane. Shpeshherë shkrimtarët do të jenë profetë, herë të kaluar dhe herë *veristë*, por Italia e tyre kthyer në letërsi, bën pjesë tek diçka tepër e rëndësishme për historinë, kulturën dhe raportin që ne si komb kemi me veten dhe ndërtojmë me tjetrin, qoftë tjetri Italia e afërt apo Evropa e pak më largët. Sensi historik i kësaj letërsie, gjithmonë në planin e atij dyzimit, si histori e treguar por dhe si kushtëzuese e historisë së mëvonshme, është evident, dhe ka të bëjë me atë të vështirë dimension të gjetjes së një identiteti dinjitoz mes të tjerësh, qofshin dhe më të fuqishëm e të rëndësishëm se ne.

Arti dhe letërsia janë produkt hapësirë-kohor e historik, por njëkohësisht dhe prodhues dimensionesh hapësinore, historike e politike. Dhe në rastin konkret *Italia e letërsisë shqiptare* paraqet një fenomen të një rëndësie qëndrore në planin si historik ashtu dhe historiografik – fatkeqësisht të pa vlerësuar siç duhet në realitetin tonë kulturor – sepse krijon atë sigurinë e gjykimit të tjetrit që në letërsi nis e merr formë, dhe që vendos një barazi mbi gjykim-vlerësime reciproke të përgjithësuara në ç’do aspekt të jetës. Është fitorja e të voglit mbi të madhin, ku kristalizohet ideja se dhe ne gjykojmë, dhe gjykimi ynë ka vlerë. Prekja e këtij fenomeni, nëpërmjet letërsisë, është e rëndësishme mbi raportet politiko-diplomatike mes vendesh dhe shumë vite më mbrapa, dhe këtë e demonstroi më së miri fenomeni Kadare në Itali, i cili me Itali të tij ka prezantuar gjithnjë vështirësi për t’u vlerësuar objektivisht e bashkë me të dhe tërësisht universi shqiptar

Bibliografi

- AA. VV. (2002), *Albanian Identities. Myth and History*, Hurst and Company, London.
- AA. VV. (1978), *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.
- AGOLLI D. (2000), *Njeriu me top*, Dritëro, Tiranë.
- ARAPI F. (1986), *Deti në mes*, Tiranë.
- BIHIKU K. (1970), *Mbi rolin e Luftës Nacionalçlirimtare për zhvillimin e letërsisë shqiptare*, in «Studime filologjike» (separat), n. 3, f. 3-18, Tiranë.
- BRAHIMI R. (1975), *Letërsia dhe artet në dritën e Paritësë*, Tiranë.
- BRAHIMI R. (1965), *Shënime letrare*, Tiranë.
- BULO J. (1982), *Romani shqiptar i realizmit socialist për Luftën Nacionalçlirimtare*, Akademia e shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë.
- CROUZET M. (1991), *Stendhal e il mito dell'Italia*, il Mulino, Bologna.
- GJATA F. (1984), *Këndvështrim më i gjerë në pasqyrimin e Luftës Nacionalçlirimtare në letërsi*, in «Nëntori» 6, XXXI, f. 227-232, Tiranë.
- GJATA F. (1954), *Përmbysja, në Vepra Letrare 4*, Tiranë.
- KADARE I. (1981), *Autobiografi e popullit në vargje në Vepra letrare 12. Publicistikë*, Tiranë.
- KADARE I. (2007), *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, në *Vepra, vëllimi i dytë*, Onufri, Tiranë.
- KADARE I. (2007), *Kronikë në gur, në Vepra, vëllimi i katërt*, Onufri, Tiranë.
- MARKO P. (1990), *Hasta la vista*, Tiranë.
- MARKO P. (2001), *Një emër në katër rrugë*, Omska-1, Tiranë.
- MARKO P. (2000), *Qyteti i fundit*, Omska, Tiranë.
- MARKO P. (1972), *Ultimatum*, Tiranë.
- MARKO P. (2010), *Nata e Ustikës, Dita*, Tiranë
- SHUTERIQI Dh. (1952-55), *Çlirimtarët (I, II)*, Tiranë.